



Planuar / Dituruar Punëhet/Prodato Received/Desvety	22-02-2023	3	Viti q/d Vitet
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr. Prot Nr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	1986/2023		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.300/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.300/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga grup ankuesish

dhe cilat i përfaqëson , me adrese rruga "Solidier Prosi" pa nr. në Mitrovicë, kundër Vendimit të datës 23.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.300/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankueset

dhe si përfaqësuese e autorizuar.

A r s y e t i m

Ankueset e punësuar në pozitën "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën Supreme, e punësuar në pozitën "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën Themelore në Gjiilan, e punësuar në pozitën "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën Themelore në Gjakovë, e punësuar në pozitën "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën Themelore në Pejë, "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, e punësuar në pozitën "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën Themelore të Ferizajt dhe e punësuar në pozitën "Zyrtare e Personelit" në Gjykatën e Apelit më datë 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1242/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit të datës 23.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokoll 1242/2023 të datës 02.02.2023 e parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor me numër protokoll 57 i datës 23.01.2023; E-mail nga . për . i datës 02.02.2023; E-mail nga . për . i datës 27.01.2023; E-mail nga . për . i datës 30.01.2023;



E-mail nga [redacted] për [redacted] datës 27.01.2023; Njoftim me numër protokoll 1334/2023 i datës 03.02.2023 lidhur me tërheqjen e ankesës ; Njoftim me sms për autorizim nga [redacted] ;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.300/2023 të datës 02.02.2023 e parashtruar nga [redacted] - grup ankuesish, *sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, gjenë se ankuesja me datë 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1242/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 03.02.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar njoftim me numër protokoll 1334/2023 për tërheqje të ankesës me numër të protokollit 1242/2023 të datës 02.02.2023 me arsyetimin se: *"Ju njoftoj se ankesën e paraqitur me datën 02.02.2023 me numër protokoll 1242/2023 nga zyrtarët e personelit të Gjykatave të Republikës së Kosovës dëshirojmë të tërheqim ankesën"*.


Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheqë atë"*, andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstaton që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.300/2023 e datës 02.02.2023 e parashtruar nga [redacted] - grup ankuesish.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.300/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

